



P.6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

"Zhvillimin Lokal të Udhëhequr nga Komuniteti pwr tw të mobilizuar dhe përfshirw komunitetet dhe organizatat lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse dhe duke nxitur kohezionin territorial".

Përmbajtja

P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	3
1. Hyrje	3
2. Politikat e zhvillimit	4
3. Funksionet	5
3.1. F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal	5
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1	5
3.2. F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë	5
3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.	6
3.3. F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike	6
3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.	6
3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1.	7
3.4.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1.	7
4. Buxhetimi i programit të Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	12
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi	14

P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

1. Hyrje

Bashkia Shkodër, në krahasim me organizimin e mëparshëm është rritur në hapësirë, ky ndryshim ka sjellë një rol të ri për zhvillimin dhe menaxhimin territorial. Në këtë situatë të re bëhet e domosdoshme përpjekja për të përcaktuar drejtimet që duhen ndjekur në të ardhmen duke u fokusuar dhe përdorur mirë burimet ekzistuese. Ndaj çështja kryesore është përkthimi i shumëllojshmërisë së avantazheve konkurruese në mundësi për investimet e huaja të cilat do të sjellin zhvillim social-ekonomik, duke bërë të mundur që çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Duke qënë se rritja ekonomike dhe hapja e vendeve të reja të punës në ekonomitë në zhvillim, varen nga dy faktorë kryesorë: tërheqja e investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit gjatë vitit 2016 ndërmoi disa nisma për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkuessve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban. Drejtoria e Turizmit, gjatë vitit 2016 me një qasje të re në hartimin e politikave të zhvillimit të turizmit, ka trajtuar çështje kritike territoriale në mënyrë të koordinuar duke ruajtur një vazhdimësi me programet sektorale të zhvillimit.

Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit, përmirësimi i infrastrukturës turistike, organizimi i panairove të atraksioneve dhe bizneseve turistike të rajonit, prodhimi i materialeve promociionale për territorin e ri të Bashkisë Shkodër, organizimi i një sërë aktivitetsh me qëllim ripërtëritjen e trashëgimisë kulturore dhe artistike, bashkëpunimi me sektorin privat në marketingun e vlerave dhe potencialeve të territorit ka ndikuar në forcimin e identitetit të rajonit duke kontribuar në rritjen e shpenzimeve të turistëve dhe për rrjedhojë në rritjen e të ardhurave për territorin.

2. Politikat e zhvillimit

Programi i zhvillimit ekonomik lokal dhe i turizmit, bazohet në 8 politika themelore:

Zhvillimi Lokal i Udhëhequr nga Komuniteti
(Mobilizimi dhe përfshirja e komunitetit dhe organizatave lokale për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të Strategjisë Europë 2020)

Investimet e Integruara Territoriale
(Aplikime me projekte konkrete në programe të ndryshme për zhvillimin e territorit).

Mbështetje për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit
(Ofrimi i shërbimeve të cilësisë së lartë, dhënie informacioni ligjor, fiskal, orientim bazuar në studimet zhvillimore të Bashkisë)

Rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve
(Konkurrueshmëria në tregjet vendore dhe ndërkombëtare nëpërmjet inovacionit, zhvillimit dhe përkrahjes së markave rajonale, zhvillimit të zinxhirëve të vlerës dhe përmirësimit të sistemeve të shpërndarjes)

Zhvillimi i fuqisë punëtore të kualifikuar sipas kërkesave të tregut të punës
(Qëndrat e punësimit, programet e reja mësimore në arsimin profesional)

Industria e turizmit, burim kryesor i rritjes ekonomike
(Nëpërmjet promovimit aktiv të politikave, turizmi do të kthehet në një mjet për integrimin e territoreve më pak të zhvilluara dhe për përmirësimin e ruajtjen e zonave të trashëgimisë)

Zhvillimi i ekuilibruar dhe endogjen i turizmit
(Rritja e vlerës së territorit si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor e ekonomik dhe burimet njerëzore)

Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit
(Kualifikim i punonjësve, rritje e cilësisë së shërbimit në fushën e turizmit)

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 “Për qeverisjen Vendore” Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si më poshtë. Për periudhën 2016-2019, kemi objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjen e detyrave funksionale. Në këtë kuadër politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër do të jenë të fokusuar në zhvillimin e një ekonomie të gjallë sipas parimit të plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale.

3. Funksionet

3.1. F1. Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal

F1.O1. Mbështetja për përmirësimin e klimës për zhvillimin e biznesit nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara, bashkëpunimit me institucione të specializuara dhe aktorët e interesuar për hartimin e strategjive dhe planeve ekonomike zhvillimore lokale.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Ngritja e Bordit të Zhvillimit Ekonomik
- Dokumenta strategjike
- Studimi për klasterat e biznesit që operojnë në Bashkinë Shkodër.
- Studimi për marketingun dhe brandimit të bizneseve të Bashkisë Shkodër

Qëllimi i këtyre dokumentave është prezantimi i përmbledhur i të gjithë informacionit lidhur me territorin e ri të Bashkisë Shkodër, i cili prezanton potencialet dhe tendencat e zhvillimit të gjithë zonës.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Një strategji dhe tre studime (studimi i klasterave dhe marketingut dhe brandimit të bizneseve të Bashkisë Shkodër. Studimi i fizibilitetit për menaxhimin e aseteve)	Një strategji dhe tre studime (studimi i klasterave dhe marketingut dhe brandimit të bizneseve të Bashkisë Shkodër. Studimi i fizibilitetit për Menaxhimin e aseteve)	Një strategji dhe tre studime (studimi i klasterave dhe marketingut dhe brandimit të bizneseve të Bashkisë Shkodër. Studimi i fizibilitetit për menaxhimin e aseteve) Plan biznese të hartuara për menaxhimin e aseteve bashkiake

3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F1.O1.A4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Shkodër	-
P6.F1.O1.A5. Studim fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër	-
P6.F1.O1.A6. Hartimi i plan bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër	-

3.2. F2. Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë

F2.O1 Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës
Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Në vitin 2016 u realizua një studim fisibiliteti për ngritjen e tregjeve. Qëllimi i studimit është ofrimi i një modeli ekonomik të arsyeshëm për funksionimin e tregjeve si dhe të përcaktojë standarte të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit tregtar në këto tregje.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Rehabilitimi i sheshit Merkatës Rus, Rregullore e hartuar për funksionimin e tregjeve të levizshme	Tregu me pakicë rr. “Pogej” funksional, Merkatoja Rus funksionale , tregje ditore të ngritura dhe funksionale.	Tregu me pakicë rr. “Pogej” funksional, Merkatoja Rus funksionale, tregje ditore të ngritura dhe funksionale. Tregu i peshkut i ngritur

3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F2.O1.A3. Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus	4,000
P6.F2.O1.A4. Përcaktimi i hapsirave dhe ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores për funksionimin e tregjeve të levizshme	2,500

3.3. F3. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike

F3.O1. Promovimi i produkteve vendore dhe fuqisë së punonjësve të specializuar për tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Gjatë vitit 2016 është organizuar një panair pune dhe një panair i bizneseve prodhuese me qëllim shkëmbimin e ideve dhe krijimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet sektorëve pjesëmarrës për një rritje ekonomike të qëndrueshme në Bashkinë Shkodër.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Janë organizuar tre panairë (dy qytet dhe një në Nj.A.)	Janë organizuar 6 panairë (dy në qytet dhe katër në Nj. Administrative)	Janë organizuar 6 panairë (dy në qytet dhe katër në Nj. Administrative)

3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F3.O1.A3. Organizimi i një panairi punë dhe bizneseve në Bashkinë Shkodër	200
P6.F3.O1.A4. Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative	200
P6.F3.O1.A5. Panair i promovimit të vlerave dhe produkteve të territorit (për Njesitë Administrative)	250

3.4. F4. Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik

F4.O1. Hartimi dhe publikimi i materialeve informative dhe promocionale për nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

Janë realizuar dy botime gjatë vitit 2016: Profili ekonomik i Bashkisë, si dhe Broshura informative për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja në Bashkinë Shkodër. Gjithashtu është përditësuar informacioni digjital për faqen ëeb të Bashkisë Shkodër.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Katër publikime: 3 botime dhe informacion dixhital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës	Pesë publikime: 4 botime dhe informacion dixhital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës	Gjashtë publikime: 5 botime dhe informacion dixhital i përditësuar në faqen web të Bashkisë së Shkodrës

3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F4.O1.A4. Profili i bizneseve të Bashkisë Shkodër	300
P6.F4.O1.A6. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).	

3.5 F5. Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi

F5. O1. Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit të biznesit vendor, nëpërmjet incentivave financiar, për zhvillimin dhe fuqizimin e tyre

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Gjatë vitit 2016 është realizuar bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër. Nga ky bashkëpunim përfituan rreth 120 biznese.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Një iniciative dhe 120 biznese përfituese, përkrahja e iniciativës për ngritjen e Zonës së përmirësimit të Biznesit për rr. Hamz Kazazi (Zdrale)	Mbështeten dy iniciativa për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit me rreth 200 biznese. Mbështetja e bizneseve në skemat e ndryshme financiare	Mbështeten dy iniciativa për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit me rreth 200 biznese. Mbështetja e bizneseve në skemat e ndryshme financiare

3.4.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F5.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F5.O1.A1. Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori	1600
P6.F5.O1.A2. Krijimi i zonave të reja BID në Bashkinë Shkodër	
P6.F5.O1.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillim me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese	-
P6.F5.O1.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	-



3.6 F6 Zhvillimi i Turizmit

F6.O1 Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale-informative.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Është hartuar guida turistike e Bashkisë Shkodër (2000 copë- gati për shtyp)
- Është hartuar kalendari i ngjarjeve kulturore (1000 copë – gati për shtyp)
- Hartimi i pesë paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike (1500- gati për shtyp)
- Hartimi i pesë paketave të integruara me produkte të ndryshme turistike (1500- gati për shtyp)
- Është krijuar data –base me të gjithë informacionin e nevojshëm për portalin ëeb për turizmin.
- Pas nje proçesi konsultimi me të gjithë grupet e interesit është përzgjedhur modeli për hartën turistike të Bashkisë Shkodër (2000 copë).
- Bashkia Shkodër në kuadër të diversifikimit të ofertës turistike, ka realizuar mbledhjen dhe sistemimin e informacionit për potencialet që ka Shkodra për organizimin e konferencave, organizimin e këtij informacioni në paketa turistike dhe marketingun e ofertës së turizmit të konferencave në bashkëpunim me sektorin privat.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Web site i dedikuar për turizmin i përditsuar i Bashkisë Shkodër, Aplikacion për smarphone me informacion turistik. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditsuar. Hartë turistike, Kalendar i ngjarjeve, kulturore. Broshurë informative për transportin e udhëtarëve. Prodhim i suvenireve të ndryshme.	Web site i dedikuar për turizmin i përditsuar i Bashkisë Shkodër, Aplikacion për smarphone me informacion turistik. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditsuar. Hartë turistike, Kalendar i ngjarjeve, kulturore. Broshurë informative për transportin e udhëtarëve. Prodhim i suvenireve të ndryshme.	Web site i dedikuar për turizmin i përditsuar i Bashkisë Shkodër, Aplikacion për smarphone me informacion turistik. Guidë turistike e Bashkisë Shkodër e përditsuar. Hartë turistike, Kalendar i ngjarjeve, kulturore. Broshurë informative për transportin e udhëtarëve. Prodhim i suvenireve të ndryshme.

3.5.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtese per ëeb sitin e turizmit.	260
P6.F6.O1.A2. Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smarphone që shërben për informimin dhe orientimin e vizitoreve.	120
P6.F6.O1.A3. Pergatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër. Perditesim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër	360
P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turistike të territorit të Bashkisë. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër.	310
P6.F6.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.	100
P6.F6.O1.A6. Prodhimi i materialeve promocionale të tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj.	200

F6.O2 Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombetare

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Në kuadër të Ditës së Turizmit, është organizuar panairi i atraksioneve dhe bizneseve turistike, i integruar me produktet artizanale, bujqësore dhe ushqimore.
- Janë prodhuar materialet promocionale për marketingun e territorit për pjesëmarrjen në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Organizimi periodik i një panairi turizmit.	Organizimi periodik i një panairi turizmi	Organizimi periodik i një panairi turizmi
Pjesëmarrje në dy panaire kombëtare dhe ndërkombëtare	Pjesëmarrje në dy panaire kombëtare dhe ndërkombëtare	Pjesëmarrje në dy panaire kombëtare dhe ndërkombëtare

3.5.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O2.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O2.A1. Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.	400
P6.F6.O2.A3. Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës.	450
P6.F6.O2.A4. Konceptimi, dizenjimi dhe prodhimi i një stende të lëvizshme për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme me qëllim promovimin e destinacionit.	350

F6.O3 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

Gjatë vitit 2016 janë organizuar :

- “Festa e Liqenit” – me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e pasurisë natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës.
- “Dita e turizmit” – në kuadër të ditës ndërkombëtare të turizmit, është organizuar ëorkshopi me temë “Turizëm për të gjithë” me pjesëmarrjen e institucioneve, universitetit dhe operatoreve turistikë
- Hapja e sezonit turistik Velipojë – me rastin e hapjes së sezonit turistik 2016, është organizuar koncerti festiv me muzikë live dhe me pjesëmarrjen e këngëtarëve më të njohur të qytetit.
- “Festa e Thethit” – në kuadër të 50 vjetorit të shpalljes së parkut kombëtar Theth dhe hapjes së sezonit turistik, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AdZM dhe GIZ, ka organizuar aktivitetin “Dalja në Bjeshkë”.
- “Dita e biçikletave” – në kuadër të javës europiane të mobilitetit, Bashkia Shkodër ka organizuar aktivitetin “Dita e Biçikletave”, që konsistoi në dhënien e disa çertifikatave mirënjohjeje, për përdoruesit e vjetër të biçikletave, xhiro demonstrative me biçikletë nëpër qytet me pjesëmarrjen e komunitetit, panairin e biçikletave, punime artistike në pikturë me temë biçikletën dhe u përmyll me ekspozitën: “Shkodra, familja ime, biçikleta ime, historia ime”
- “Triathlon” – në kuadër të zhvillimit të sportit dhe turizmit në liqenin e Shkodrës, Bashkia Shkodër organizoi aktivitetin e përvitshëm “Triathlon” – një kompeticion tre garësh: not, çiklizëm dhe vrapim.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Organizimi i 35 aktiviteteve social kulturore dhe sportive	Organizimi i 35 aktiviteteve social kulturore dhe sportive	Organizimi i 35 aktiviteteve social kulturore dhe sportive

3.5.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O3

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O3.A1. Festa e Liqenit	300
P6.F6.O3.A2. Dita e turizmit	250
P6.F6.O3.A4. Hapja e sezonit turistik Velipojë	400
P6.F6.O3.A5. Festa e Thethit	400
P6.F6.O3.A6. Dita e biçikletave	300
P6.F6.O3.A7. Triathlon	250

F6.O4. Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për përmirësimin e shërbimit ndaj vizitorit.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Krijimi i Drejtorisë së Turizmit me 8 nëpunës. Ngritja e tre Zyrave të Informacionit Turistik në tre njësi administrative të territorit të Bashkisë Shkodër.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Drejtoria e Turizmit ushtron aktivitetin e saj në funksion të zhvillimit të turizmit në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.	Drejtoria e Turizmit ushtron aktivitetin e saj në funksion të zhvillimit të turizmit në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.	Drejtoria e Turizmit ushtron aktivitetin e saj në funksion të zhvillimit të turizmit në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.
Në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër janë tre zyra të informacionit turistik	Në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër janë tre zyra të informacionit turistik	Në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër janë tre zyra të informacionit turistik.

3.6.4. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O4

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O4.A1. Vazhdimi i aktivitetit të drejtorisë së Turizmit, Zyrës së Informacionit Turistik në territorin administrativ të qytetit Shkodër, Zyrës së Informacionit Turistik në njësinë administrative Velipojë, Zyrës së Informacionit Turistik në Theth	

F6.O5 Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe Universitetin.

Situata e vlerësuar në fund të vitit 2016:

- Vlerësohet nevoja e krijimit të një strukture konsultative të përbërë nga aktorë të interesit për zhvillimin e turizmit në Shkodër.
- Ka studime nga aktorë të ndryshëm. Verësohet nevoja e hartimit të një studimi të plotë vetëm për destinacionet turistike të Bashkisë së Shkodrës

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Ngritja e bordit këshillimor të Turizmit, Një plan studimor (Plani i marketingut)	Bordi këshillimor i zhvillimit të turizmit zhvillon aktivitetin e vet sipas një kalendari të caktuar takimesh. Bashkia ka dy plane studimore (Plani i marketingut dhe i sinjalistikës turistike)	Bordi këshillimor i zhvillimit të turizmit zhvillon aktivitetin e vet sipas një kalendari të caktuar takimesh. Bashkia ka dy plane studimore (Plani i marketingut dhe i sinjalistikës turistike)

3.6.5. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O5

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O5.A2. Hartimi i planit të sinjalistikës turistike të Bashkisë Shkodër.	400

F6.O6 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2016:

- Janë zhvilluar trajnime të punonjësve që punojnë në fushën e turizmit. Vlerësohet nevoja e mëtejshme për trajnime të mëtejshme me qëllim përmirësimin e shërbimeve.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Një trainim (me gra në biznese turistike). Numri i bizneseve pjesmarrëse 15 numri i punonjësve të trajnuar 20.	Një trainim (për guidat turistike). Numri i guidave të trajnuar 20.	Një trainim (me bizneset e shërbimeve turistike). Numri i bizneseve pjesmarrëse 15 Numri i punonjësve të trajnuar 20.

3.6.6. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O6

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O6.A1 Trajnime me gratë sipërmarrëse që operojnë në clustera të ndryshme të bizneseve turistike.	300

F6.O7 Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe aksesit.

Situata e vlerësuar në fund te vitit 2016:

- Në kuadër të nxitjes së zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të vlerave ekologjike, kulturore dhe etnografike, Bashkia Shkodër në bashkepunim me IUCN dhe *Ride Albania Mountain Biking*, ka realizuar krijimin e 7 shtigjeve të reja përgjatë lumit Buna dhe Velipojë – Baks Rrjoll.
- Me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe financimin e GIZ, Bashkia Shkodër ka realizuar vendosjen e 6 tabelave informative turistike në pikat kryesore të qytetit.
- Ka përfunduar konceptimi dhe është miratuar përmbajtja e informacionit të 10 tabelave informative turistike, që do të vendosen në objektë të interesit për vizitorët.

Situata e synuar 2017	Situata e synuar 2018	Situata e synuar 2019
Situatë e permiresuar dhe vendosja në funksionalitet i ballkonit jugperendimor të kalasë.	Rehabilitim i molit në liqenin Vau Dejës. Plotësim i infrastrukturës turistike përgjatë rrugës (bregut të liqenit) Ura e Bunës Shirokë. Mirëmbajtje e shtigjeve dhe sinjalistikës në Theth. Permirësim i aksesit në shpellën e Gajtanit.	Permirësim aksesit atraksion turistik (Juban). Blerje biçikletash në shërbim për vizitorët.

3.6.7. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F6.O7.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë
P6.F6.O7.A4. Permirësimi i vizitueshmërisë së ballkonit jugperëndimor të kalasë nëpërmjet pastrimit të vegetacionit dhe ngritjes së një strukture të lëvizshme (që mund të çmontohet në çdo moment) prej druri ose metalike	700


4. Buxhetimi i programit të Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit

Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Zhvillimit ekonomik lokal dhe turizmit planifikohet buxheti me vlerë totale 14,900 mijë lekë ndër të cilat, 24 % shpenzime operative, 54% investime, 22 % transferta.

Tabelë 1 Planifikimi për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi


Programi P6	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvencioni	Transferta	Investime	Totali
Plani 2016	0	5,520	0	1,600	0	7,120
Plani i ndryshuar 2016		5,520		1,600		7,120
I pritshmi 2016-12-mujor		2,600		1,600		4,200
Plani 2017	0	3,600	0	3,350	7,950	14,900
Plani 2018	0	6,010	0	3,550	21,550	31,110
Plani 2019	0	4,220	0	4,900	18,150	27,270

P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi



Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi

Burimet e financimit për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi



Grafik 2 Burimet e financimit për financimin e programit për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi

5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi

Nr. 4	P6.F1.O1.A4. Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit: P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni: P6.F1. Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillim, i cili përfshin identifikimin dhe shfrytëzimin kryesisht të burimeve vendore, ideve dhe aftësive për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ky proces shoqërohet me 'monitorimin dhe vlerësimin' e tij, si mekanizëm tepër i vlefshëm për të treguar nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efektivitet dhe nëse po bëhet ajo që është planifikuar. Si rrjedhojë, Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë e garantimit, që plani i zhvillimit ekonomik të përmbushë objektivat e deklaruara dhe me efektivitet kostoje për dy arsye kryesore, marrjen e vendimeve dhe vendosjen e përgjegjshmërisë.							
ii. Synimi i projektit							
Projekti ka për qëllim të monitorojë dhe vlerësojë Planin e Përgjithshëm Vendor, të raportojë mbi bazën e alokimit faktik të burimeve financiare dhe të masë rezultatet e arritura në raport me rezultatet e planifikuara.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i planit për analizën e të dhënave. - Analizimin e të dhënave për ndikimin e planit, zbatimin e aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve, efikasitetin dhe efektivitetin e tij. - Gjetjen e rekomandimeve dhe konkluzioneve. - Përgatitjen e raportit të monitorimit dhe vlerësimit. - Shpërndarja e informacionit 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> - Realizimi i monitorimit për çdo vit në fund të një viti fiskal i Planit të Përgjithshëm Vendor për situatën aktuale dhe zbatimin e PPV-së për identifikimin e problemit, gjetjen e zgjidhjes dhe matjen e progresit ndaj rezultateve të dhëna. - Realizimi i vlerësimit të kryer në mes dhe në fund të përfundimit të zbatimit të i Planit të Përgjithshëm Vendor që analizon dhe vlerëson gjithë informacionin e procesit të monitorimit. 							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Grupet e Interesit				Bashkia Shkodër, Donatore, Programe të BE.			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017			Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	
A.1	Hartimi i planit për analizën e të dhënave.						
A.2	Analizimin e të dhënave për ndikimin e planit, zbatimin e aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve, efikasitetin dhe efektivitetin e tij.						
A.3	Gjetjen e rekomandimeve dhe konkluzioneve.						
A.4	Përgatitjen e raportit të monitorimit dhe vlerësimit.						
A.5	Shpërndarja e informacionit						
Shuma			0				
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Për çdo vit në fund të një viti fiskal. 2017 2018 2019			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				

Nr.5	P6.F1.O1.A5. Studim fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F1 Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Bashkia Shkodër ka një shtrirje gjeografike e cila fillon nga Veriu i Alpeve Shqiptare deri ne Bregdetin Adriatik duke përfshirë një sërë resursesh. Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore. Menaxhimi i duhur i aseteve ka shumë rëndësi për menaxhimin e mirë financiar vendor. Menaxhimi më i mirë i aseteve mund të përmirësojë drejtpërdrejtë zhvillimin ekonomik, duke ulur humbjet dhe kostot e panevojshme operative dhe duke identifikuar mundësitë e reja të zhvillimit. Ky Studim do të shërbejë në identifikimin e mënyrave efikase e krijuese për shfrytëzimin e pasurive të tyre të reja për të përmirësuar cilësinë dhe sasinë e shërbimeve që sigurojnë për qytetarët e tyre. Gjithashtu ky studim fizibiliteti do të krijojë mbështetje edhe për punën teknike në aplikimin e metodave që mbështesin zhvillimin e investimeve kapitale dhe planifikimin e përdorimit të tokës brenda kapaciteteve të përgjithshme të huamarrjes vendore apo të krijimit të partneriteteve të reja Publik – Privat.							
ii. Synimi i projektit							
Ky projekt synon në hartimin e një studimi i cili do të orientojë mundësitë e reja të menaxhimit dhe zhvillimit të aseteve të Bashkisë Shkodër në fushat e zhvillimit ekonomik, apo shërbimeve							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër. 2. Takime konsultative me aktorët e interesuar për hartimin e studimit të Fizibilitetit për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. 3. Identifikim i kuadrit legjislativ dhe praktikave më të mira të menaxhimit të aseteve 4. Hartim i studimit të Fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër 							
b) Rezultatet që prisni							
Studimi i fizibilitetit do të mund të nxisë dialogun dhe përhapjen e informacionit mes aktorëve kryesorë njësitë vendore, institucionet financiare apo bizneset për të gjetur mundësitë e bashkëpunimit në menaxhimin e aseteve dhe për të evidentuar përjasje të reja për menaxhimin e tyre							
c) Aktoret e mundshëm			d) Kontributet e mundshme ne projekt				
Bashkia Shkodër Universiteti i Shkodër Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Bizneset			Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)		
					Nga kjo:		
A			Pa	Sigu	Oper	Transf	Kapi
.1	Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër.		ga	rime	ative	erime	tale
A							
.2	Takime konsultative me aktorët e interesuar për hartimin e studimit të Fizibilitetit për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër						
A							
.3	Identifikim i kuadrit legjislativ dhe praktikave më të mira të menaxhimit të aseteve						
A							
.4	Hartim i studimit të Fizibiliteti për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër						
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar 2017 – dhjetor 2017 Janar 2018 – dhjetor 2018			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				

Nr.6	P6.F1.O1.A6. Hartimi i plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F1 Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;								
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit										
i. Situata										
Menaxhimi i aseteve ka shumë përfitime pozitive. Institucionet që vendosin në zbatim parimet të menaxhimit të aseteve arrijnë të kenë shumë përfitime të cilat fillojnë që nga mirë administrimi i tyre deri tek gjenerimi i të ardhurave nga ky menaxhim. Me përfundimin e studimit të fizibilitetit për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër do të fillojë faza e hartimit të Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të identifikuar në këtë studim sipas funksioneve dhe potencialeve të secilit aset duke krijuar premiset e investimeve dhe gjetjes së partneriteteve. Menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë. Praktikrat e menaxhimit të aseteve janë akoma një risi për institucionet Shqiptare prandaj duhen marrë praktikrat më të mira të zhvilluara në vendet e BE në hartimin e planeve të biznesit për menaxhimin e tyre. Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve do të luajë rol në një përqendrim më të mirë të tyre drejt përparësive të zhvillimit ekonomik sipas planit të fizibilitetit të kryer nga Bashkia. Plan Bizneset do të japin një kuptim më të qartë të riskut/pasojave të vendimeve për investimet përkatëse dhe do të jenë mjete të besueshëm për vendim-marrjen dhe planifikimin e investimeve dhe bashkëpunimeve në të ardhmen.										
ii. Synimi i projektit										
Vënia në funksion të aseteve për gjenerimin e të ardhurave dhe shërbimeve										
iii. Aktivitetet kryesore të projektit										
<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin. 2. Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër. 3. Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit. 4. Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër 										
b) Rezultatet që prisni										
Nxitje e investimeve në asetet publike dhe private të Bashkisë Shkodër në shërbim të zhvillimit										
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt						
Bashkia Shkodër Universiteti i Shkodër Dhoma e Tregtisë Bizneset Komuniteti				Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	
	Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin.									
	Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër.									
	Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit.									
	Shuma			0						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale	
A.1	Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin.									
A.2	Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër.									
A.3	Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit.									
A.4	Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër									
	Shuma			100			100			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurime	operative	Transferime	Kapitale	
A.1	Identifikimi i aseteve të Bashkisë Shkodër dhe i orientimit zhvillimor që duhet të marrin.									
A.2	Takime konsultative me aktorët e interesuar për zhvillimin e aseteve të Bashkisë Shkodër.									



A. 3	Takim me Investitorë të ndryshëm për gjetjen e mundësive të bashkëpunimit.						
A. 4	Hartimi i Plan Bizneseve për menaxhimin e aseteve të Bashkisë Shkodër						
	Shuma	100			100		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar 2017 – dhjetor 2017 Janar 2018 – dhjetor 2018 Janar 2019 – dhjetor 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit					

Nr. 9	P6.F2.O1.A3 Rehabilitim mirembajtje e merkatos në Rus	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F2: Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë							
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:									
i. Situata									
Merkato Rus nuk funksionon me kapacitetin e saj te plote si rezultat i gjendjes se saj jo te mire. Një vëzhgim i bërë në tregjet publike, vihet re se hapësirat e posaçme që Bashkia e ka vënë në dispozicion nuk shfrytëzohen të gjitha sepse kane nevojë per permiresime te vazhdueshme Reabilitimi dhe mirembajtja e merkatos do sillte jo vetem tregtimin ne kushte te pershtatshme qe do te rriste edhe vete cilesine e produkteve por mbi te gjitha do te nxise formalizimin e ketij sektori. Aktualisht në tregjet ekzistuese, që janë tregje publike, duhet bërë një plan rehabilitimi për këta. Bashkia e Shkodrës është duke bërë një studim vizibiliteti për hapësira të reja dhe për tregjet aktuale që të jenë sa më funksionale dhe sa më pranë qytetarit.									
ii. Synimi i projektit									
Reabilitimi i merkatos Rus do sherbeje per te permiresuar kushtet e tregtimit sipas standarteve per shitesit dhe bleresit e pakices									
iii. Aktivitetet kryesore të projektit									
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e infrastruktures ekzistuese te merkatos Rus dhe evidentim i nevojës për rehabilitim; 2. Hartimi i projektit per rehabilitim 3. Zbatim i projektit duke perfshire <ul style="list-style-type: none"> • rikonstruksion strehe, • banakesh, • lysterje fasdash, • riparime te sistemit ujesjellesit, • KUZ, • Riparim ËC • Sigurim ndricimi 4. Supervizim 5. Kolaudim 									
b) Rezultatet që prisni									
Rehabilitim, mirëmbajtje dhe risistemim i Merkatos Rus									
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt					
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër AZHR 1				Bashkia Shkodër					
e) Shpenzimet e llogaritura									
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017				Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
					Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapital e
A.1	Hartimi i projektit teknik të rikonstruksionit			0					
A.2	Zbatim i projektit të plotë të rikonstruksionit të pjesshëm			4,000					4,000
A.3	Supervizim								
	Kolaudim								
	Shuma			4,000					4,000
f) Periudha e zbatimit janar 2017 – dhjetor 2017				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit strategjik dhe përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve					

Nr.10	P6.F2.O1.A4 Percaktimi i hapsirave dhe ngritja e tregjeve ditore sipas projektit dhe rregullores per funksionimin e tregjeve te levizshme	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F2: Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Prodhuesit e bashkise Shkoder ankohen sepse nje sasi e konsiderueshme e prodhimit te tyre nuk po arrin ne treg per arsye te largesise me tregun. Nga ana tjeter edhe bleresit e lagjeve te medha kane nevojte per tregje te perkohshme afer zonave te tyre te banimit. Situata aktuale eshte se ne lagje te vecanta kemi grumbullime fermeresh te cilet shesin produktet e tyre ne kushte joformale dhe johigjenike. Gjatë vitit 2016 janë identifikuar rreth 450 shitës fermerë ambulantë me pakicë që paraqesin nevojën për përcaktimin e një hapësire për tregëtim.</p> <p>Per fermeret eshte i nevojshem percaktimi i nje hapsire publike tregtimi te perkohshme. Krijimi i zonave te vecanta per tregje ditore mund te behet ne lagje qe e kane te nevojshem nje treg, por kjo sherben edhe si ide per fillimin e tregjeve ne NJ.A tona. Mund te fillohet me sinjalistika krejt te thjeshte dhe me sherbimet e nevojshme si uje e ndricim. Mjafton qe te ndahen hapsirat e tregtimit per cdo fermer, te dihet se kujt i perket hapsira e tregtimit dhe kjo hapsire te jete e paster dhe e rregullt pas orarit te mbylljes se tregut. Megjithate mund te konceptohet edhe me nje sistem banakesh dhe tendash te levizshme, te cilat palosen ne fund te dites. Ideja eshte se nuk do lejohen ndertime ne keto siperfaqe publike pasi keto tregje do jene te perkohshme. Ne kete menyre do te krijojme nje pamje me te rregullt tregtimi dhe nje imazh me pozitiv per qytetin.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Percaktimi i hapsirave per tregjet ditore, ndertimi i tyre dhe hartimi i rregullores per funksionimin e ketyre tregjeve me qellim ofrimin e sherbimit me te mire per prodhuesit bleresit dhe tregtaret.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Analize situatë dhe evidentim i nevojës për tregje ditore dhe të levizshme 2. Hartimi i projektit 3. Zbatimi i projektit nepermjet rregullim te sinjalistikes, vijeze dhe sherbimeve te tjera mbeshtetese 4. Supervizim 5. Kolaudim 6. Hartim i rregullores per funksionim e tregjeve ditore dhe te levizshme. 							
b) Rezultatet që prisni							
Permiresimi i standarteve te tregtimit dhe rritje e kenaqesise konsumatore ne blerje.							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Fermeret				Bashkia shkoder			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Zbatimi i projektit nepermjet rregullim te sinjalistikes, vijeze dhe sherbimeve te tjera mbeshtetese		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.2	Supervizim						2,500
A.3	Kolaudim						
Shuma		2,500					2,500
f) Periudha e zbatimit Janar 2017-dhjetor 2017		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit Drejtorja e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve					

Nr.15	Projekti: P6.F3.O1.A3 Organizimi i një panairi pune dhe bizneseve ne Bashkine Shkoder	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F3 Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike;								
a) Pershkrimi i shkurter i projektit										
i. Situata										
Rajoni i Shkodrës, është i prekur nga një numër i lartë i të papunëve. Në Universitetin e Shkodrës si dhe në shkollat profesionale çdo vit diplomohen një numër i konsiderueshëm studentësh, të cilët kanë vështirësi të integrohen në tregun e punës. Nga ana tjetër në Bashkinë e Shkodrës operojnë një numër relativisht i mirë i aktiviteve ekonomike të sektorëve të ndryshëm të cilët gjithashtu herë pas here kanë vështirësi në gjetjen e punonjësve e sidomos të atyre të kualifikuar. Kjo gjë ndodh nga mungesa e informacionit si për vendet e punës së disponueshme por gjithashtu edhe për mundësitë që kanë bizneset për të punësuar punonjës të kualifikuar. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër, ashtu si vitin e kaluar, ka parashikuar organizimin e panairit të përvitshëm të punës me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces ku mund të përmendim Universitetin e Shkodrës, shkollat e mesme profesionale dhe bizneset që kanë aktivitet në Shkodër e më gjërë. Në këtë panair, bizneset do të kenë mundësi të promovojnë produktet e tyre, si një mundësi për tu njohur në tregun rajonal e më gjërë si dhe të njihen me potencialin e fuqisë punëtore të kualifikuar.										
ii. Synimi i projektit										
Ky projekt synon të shkëmbimin e informacionit për mundësitë e tregut të punës si për punëkërkuarit ashtu edhe për punëdhënësit. Si dhe shkëmbimin e informacionit mes bizneseve dhe krijimin e mundësisë për promovimin e produkteve të tyre.										
iii. Aktivitetet kryesore të projektit										
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e programit të panairit 2. Përgatitja e materialeve promovionale si postera, banera, ftesa etj. 3. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit 4. Njoftimet ne media elektrtonike per zhvillimin e aktivitetit 										
b) Rezultatet që prisni										
Njohja dhe prezantimi në rajon e më gjerë e produkteve të bizneseve prodhuese që operojnë në Bashkinë Shkodër.										
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt						
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër Shkollat e mesme profesionale				Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1 Përgatitja e materialeve promovionale si postera , banera , ftesa etj.						Pag a	Sigurim e	Operati ve	Transferi me	Kapital e
A.2 Instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit										
Shuma					200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1 Përgatitja e materialeve promovionale si postera , banera , ftesa etj.						Pag a	Sigurim e	Operati ve	Transferi me	Kapital e
A.2 Instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit										
Shuma					200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A.1 Përgatitja e materialeve promovionale si postera , banera , ftesa etj.						Pag a	Sigurim e	Operati ve	Transferi me	Kapital e
A.2 Instalimi i logjistikes per zhvillimin e panairit										
Shuma					200			200		
f) Periudha e zbatimit Shtator 2017 – dhjetor 2017 Shtator 2018 – dhjetor 2018 Shtator 2019 – dhjetor 2019					g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit					

Nr. 16	P6.F3.O1.A4 Panairi i produkteve agropërpunuese sipas njësive administrative	Llojet e programit: P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit. Funksioni:P6. F3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.
--------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Bashkia Shkodër për shkak të pozicionimit gjeografik dhe resurseve natyrore që disponon ka potenciale të madhe për zhvillimin ekonomik. Baza ekonomike është blektoria, sidomos në zonën malore të saj, ndërsa në zonën fushore përparësi ka bujqësia, kryesisht drithërat e bukës. Përveç tyre, produkte të tjera tipike të zonës janë të lidhura me vreshtarinë, ullishtat dhe frutat/perimet. Po ashtu, afërsia me liqenin ka nxitur edhe peshkimin. Kjo pasuri mund të hulumtohet nga aspekte të ndryshme, sepse paraqet një fushë të gjërë, ku pa dyshim një vend të rëndësishëm zënë produktet agropërpunuese. Sektori i agropërpunimit është një ndër sektorët e ekonomisë e cila gërsheton potencialet e burimeve natyrore, pozitën gjeografike, traditën e rajonit por gjithashtu edhe interesin në rritje të aktorëve dhe partnerëve të rëndësishëm për rajonin. Si e tillë vërehet praninë e bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Por përtej mundësive që vendi ofron ky sektor ndeshet me disa problematika që kanë të bëjnë kryesisht me investimet për modernizimin e teknologjisë, standardizimin, konkurrueshmërinë, nxitjen e promovimit të markave rajonale, kapacitetet menaxhuese etj. Në këtë kuadër me qëllim zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse do të organizohet panairi i produkteve agropërpunuese. Në këtë panair do të prezantohen të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër me produktet vendase, me pasuritë e tyre kulturore dhe ushqimin tradicional, secila do të ndërtojë në panairi standin e saj. Ky manifestim do të jetë i tipit të hapur për pjesëmarrësit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë prodhues e më shumë prodhime vendase.

ii. Synimi i projektit

Ky projekt ka për qëllim promovimin e produkteve të sektorit agropërpunuese sipas njësive administrative të Bashkisë Shkodër.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përgatitja e programit të panairit të produkteve agropërpunuese.
2. Përgatitja e materialeve promociionale si postera , banera , ftesa etj.
3. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit.
4. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit.

b) Rezultatet që prisni

Pjesëmarrje e një numri të gjërë prodhuesish të produkteve vendase, përfaqësimi i 11 njësive administrative në panair me produktet që i karakterizojnë.

c) Aktorët e mundshëm

Bashkia Shkodër
Dhoma e Tregëtisë
Bisnese Prodhuesish
Shoqata që operojnë në këtë fushë

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër
Donatorë

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Përgatitja e materialeve promociionale si postera , banera , ftesa etj.						
A. 2	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit						
Shuma		200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A. 1	Përgatitja e materialeve promociionale si postera, banera , ftesa etj.						
A. 2	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit						
Shuma		200			200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali	Nga kjo:				



		(mije lekë)	Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Përgatitja e materialeve promovionale si postera, banëra , ftesa etj.						
A.2	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikes për zhvillimin e panairit						
	Shuma	200			200		
f) Përiudha e zbatimit Për çdo vit: 2017 2018 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtorja e Bujqësisë pranë Bashkisë Shkodër					

Nr. 17	P6.F3.O1.A5 Panairi i promovimit të vlerave artistike – kulturore dhe i produkteve të territorit (për Njësitë Administrative)	Llojet e programit: P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni: P6.F3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Territori i ri i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, rrethinat dhe malësitë e bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga veshje tradicionale funksionale për cdo ceremoni dhe për jetën e përditshme. Të tilla janë, kostumet e qytetit (të komunitetit musliman, atij katolik e atij ortodoks), të zonave rurale (të Postribës, të Zadrimës, të Bregut të Bunës etj), të Malësive (Shale, Shoh, Pult). Një larmi tejet të madhe edhe në shkallë vendi paraqet bashkia për sa i përket pasqyrimin të shpirtit njerëzorë përmes këngës, vlen për tu theksuar ahengu shkodran, këndimi me lahutë i rapsodive të vjetra kreshnike, këngët e shoqëruara me çifteli, vallëzimi në çift ose në grup. Po ashtu Bashkia e re është dalluar për një numër të madh prodhimesh tradicionale me bazë burimet dhe kushtet natyrore të saj.</p> <p>Në këtë kuadër është parashikuar organizimi i panairit në katër njësi administrative. Ato do të prezantohen me pasuritë e tyre kulturore, veshje, grupe folklorike dhe ushqim tradicional. Ky panair vlerësohet si një mundësi shumë e mirë për të promovuar vlerat kulturore, pasuritë natyre që vendi ka por edhe produktet e sektorit të agrobiznesit. Strukturimi i njësive administrative për marrjen pjesë në panair do të bëhet mbi bazën e fqinjësisë së mirë, traditës dhe zakoneve që këto njësi kanë me njëra tjetrën. Zhvillimi i panairit do të përkohë edhe me festat tradicionale të zonës që njësitë administrative festojnë. Ky manifestim do të jetë i tipit të hapur për pjesëmarrësit. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme me më shumë aktiviteteve kulturore e më shumë prodhime vëndase. Ky aktivitet konsiston në dy drejtime: organizimin e aktivitetit artistik të vlerave kulturore të zonave (promovimin e veshjeve tradicionale, këngë dhe valle të zonave) si dhe organizimin e panairit të produkteve të territorit (për njësitë administrative).</p> <p>Në vitin 2017 janë parashikuar të zhvillohen 2 aktivitete në dy njësi administrative. Për vitin 2018 dhe 2019 do të zhvillohen katër aktivitete/për vite. Aktiviteti artistik i vlerave kulturore të zonave do të përzgjidhet nga Këshilli Artistik Kulturor i Bashkisë Shkodër.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Ky projekt ka për qëllim promovimin e vlerave tradicionale të trashëgimisë kulturore dhe produkteve vëndase të njësive administrative të Bashkisë Shkodër.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave. 2. Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave. <ol style="list-style-type: none"> a. Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit b. Përgatitja e materialeve promociionale si postera , banera , ftesa etj. 3. Njoftimet në media për zhvillimin e aktivitetit 							
b) Rezultatet që prisni							
Realizimi panairit, marrja pjesë e një numri të gjerë prodhuesish të produkteve vendase, përfaqësimi i njësive administrative në panair me vlerat dhe produktet që i karakterizojnë. Në vitin 2017 janë parashikuar te zhvillohen 2 aktivitete ne dy njësi administrative. Për vitin 2018 dhe 2019 do te zhvillohen katër aktivitete/për vite							
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Biznese Prodhuesish Shoqata që operojnë në këtë fushë Banoret e Nj. Administrative				Bashkia Shkodër Donatorë			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktivitet artistik i vlerave kulturore të zonave.	100				100	
A.2	Përgatitje e panairit të produkteve agro-përpunuese të zonave.	150		150			
A.2.1	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit.						

A.2.2	Përgatitja e materialeve promociionale si postera, banera , ftesa etj						
	Shuma	250		150	100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktiviteti artistik i vlerave kulturore të zonave.						
A.2	Përgatitja e panairit të produkteve agropërpunuese të zonave.						
A.2.1	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit.						
A.2.2	Përgatitja e materialeve promociionale si postera, banera , ftesa etj						
	Shuma	600		600			
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Aktiviteti artistik i vlerave kulturore të zonave.						
A.2	Përgatitja e panairit të produkteve agropërpunuese të zonave.						
A.2.1	Përgatitja e sheshit dhe instalimi i logjistikës për zhvillimin e panairit.						
A.2.2	Përgatitja e materialeve promociionale si postera, banera , ftesa etj						
	Shuma	600		600			
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Për çdo vit: 2017 2018 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtorja e Kultures, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve					

Nr.21	P6.F4.O1.A4. Publikim i profilit të bizneseve të Bashkisë Shkodër.	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F4 Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.;						
a) Pershkrimi i shkurter i projektit								
i. Situata								
Hartimi i profileve të bizneseve të Bashkisë Shkodër synon të ofrojë një përmbledhje të historive të suksesit të ketyre bizneseve, duke bërë një historik të shkurter qe nga krijimi i tyre e deri ne ditet tona, e gjitha kjo e pasuar edhe me llojet e produkteve qe keto ndermarrje prodhojne. Nga hartimi i ketyre profileve do te botohet nje katalog, i cili do te ofroje nje panoramike te sipermarrjeve lokale dhe produkteve të tyre, duke dhene mundesine cdokujt te njohe me mire prodhimet apo sherbimet qe ato ofrojne , kapacitetin e prodhimit etj. Ky botim do të jetë i disponueshëm edhe ne faqen ëeb te bashkise ne forme elektronike.								
ii. Synimi i projektit								
Ky projekt synon promovimin e sipermarrjeve të suksesshme, të produkteve që ato ofrojnë si dhe njohjen e tyre nga ana e punkërkuësve.								
iii. Aktivitetet kryesore te projektit								
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përzgjedhja e bizneseve më të suksesshme të Bashkisë Shkodër. 2. Takimi me bizneset e përzgjedhura për hartimin e profilit. 3. Përgatitja e struktures së profilit. 4. Përgatitja e draftit dhe publikimi i tij. 								
b) Rezultatet që prisni								
Profilet e ndërmarrjeve prodhuese të realizuara. Përgatitja e draftit per botim. Promovimi i publikimit.								
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë Universiteti i Shkodër Sipermarrje te ndryshme.				Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për cdo aktivitet 2017			Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Përgatitja e draftit dhe publikimi i profilit të bizneseve					300		
Shuma			300			300		
f) Periudha e zbatimit 2017				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				

Nr. 23	P6.F4.O1.A6. Publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore (për investime vendase dhe të huaja).	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F4 Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.;								
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit										
i. Situata										
<p>Bashkia Shkodër ka tashmë një shtrirje territoriale të madhe dhe gjithashtu ka edhe detyrën e shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për të arritur këtë qëllim duhet bërë një klasifikim i zonave zhvillimore sipas pozicioneve përkatëse gjeografike dhe sipas sektorëve të zhvillimit. Një pikë e rëndësishme është seleksionimi i industrive dhe funksioneve ekonomike të zonave zhvillimore, duke zgjedhur industri të lehtë, zhvillim turizmi apo bujqësie që është jo dëmtuese për mjedisin apo duke i bashkuar me industri të tjera plotësuese ose që ndajnë karakteristika të përbashkëta dhe mund të funksionojnë së bashku. Promovimi i zhvillimit në zonat ekonomike dhe në fashat e zhvillimit ekonomik të përcaktuara në strategjinë e territoriale të Bashkisë Shkodër të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zona e ish-fushës së aviacionit- zonë e lirë ekonomike • Ish-zonës industriale Shkodër (rikualifikim i Broënfield) • Bypassi në një itinerarë natyror • Aksit Ura e Bahçallëkut -Bërdicë si aks ekonomik • Fashat ekonomike: Bashkinë Shkodër Aksi Shkodër -Koplik • Aksit rrugor Shkoder - Ana e Malit - Muriqan • Fashat ekonomike - Aksi Shkodër - Vau i Dejës • Rruga Shirokë- Zogaj • Zona e Qendrës Shkodër • Zona pranë By-Pass Perëndimor • Terminali ujqor • Zona Velipojë-Rrjoll <p>Një nga masat e bashkisë për të krijuar mundësinë e zhvillimit të këtyre zonave do të jetë edhe promovimi dhe tërheqja e investitorëve vendas dhe të huaj.</p> <p>Përmes bashkëpunimit me drejtorinë e kontrollit dhe zhvillimit të territorit dhe drejtorinë juridike do të detajohen rregulloret dhe procedurat për zhvillimin e këtyre zonave. Faza tjetër do të jetë përgatitja dhe publikimi i materialeve promocionale për zonat zhvillimore, duke iu referuar rregulloreve dhe procedurave të përcaktuara.</p>										
ii. Synimi i projektit										
Zhvillimi i zonave ekonomike përmes tërheqjes së investimeve vendase e të huaja										
iii. Aktivitetet kryesore të projektit										
<ol style="list-style-type: none"> 5. Takime konsultative me aktorët e interesuar. 6. Përgatitja e dokumenteve teknike për funksionimin e zonave zhvillimore. 7. Përgatitja e draftit, botimi dhe publikimi i materialit promocional për zonat zhvillimore 										
b) Rezultatet që prisni										
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt						
Bashkia Shkodër Universiteti i Shkodër Dhoma e Tregtisë Bizneset Komuniteti				Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
						Pag a	Siguri me	operati ve	Transferi me	Kapita le
A.1	Takime konsultative me aktorët e interesuar.									
A.2	Përgatitja e dokumenteve teknike për funksionimin e zonave zhvillimore.									
Shuma										
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
						Pag a	Siguri me	operati ve	Transferi me	Kapita le
A.3	Përgatitja e draftit dhe publikimi i materialit promocional për zonat zhvillimore				200			200		
Shuma					200			200		
f) Periudha e zbatimit Janar 2017 – dhjetor 2017 Janar 2018 - dhjetor 2018					g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit					

Nr.24	Projekti: P6.F5.O1.A1 Bashkepunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F5. Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.										
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit												
i. Situata												
Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe Kolë Idromeno. Shoqata BID dhe Bashkia bashkëpunojnë për të organizuar veprimtari, të cilat përfshijnë komunitetin dhe promovojnë zonën. Qëllimi kryesor i Zonës së Përmirësimit të Biznesit është krijimi i mundësive ekonomike të përmirësuar, siguri dhe një klimë të mirë biznesi mes anëtarëve të saj. Si rezultat i këtij bashkëpunimi janë bërë investime infrastrukturore të mëdha në krijimin e shetitores rr. 13 Dhjetori dhe 28 Nëntori. Rikualifikimin e fasadave dhe përmirësimin e shërbimeve publike të zonës. Vetë shoqata zhvillon shumë aktivitete social kulturore duke e bërë një nga zonat më tërheqëse për vizitorët.												
ii. Synimi i projektit												
Mbështetja e biznesit të vogël për t'u konsoliduar dhe rritur aktivitetin e tyre ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.												
iii. Aktivitetet kryesore të projektit												
Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të ardhurave nga tarifat, që mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anëtare të shoqatës sipas marreveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr 13, date 12.03.2012.												
b) Rezultatet që prisni												
Forcimi dhe zhvillimi i bizneseve egzistuese, krijimi i bizneseve të reja si dhe rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, që ndodhen përgjatë rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”												
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt								
Bashkia Shkodër AADF BID Shkodër				Bashkia Shkodër								
e) Shpenzimet e llogaritura												
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:						
<table border="1"> <tr> <td data-bbox="177 1290 252 1406">A.1</td> <td data-bbox="252 1290 884 1406">Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.</td> </tr> </table>					A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.											
Shuma					1600			1600				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:						
<table border="1"> <tr> <td data-bbox="177 1574 252 1648">A.1</td> <td data-bbox="252 1574 884 1648">Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.</td> </tr> </table>					A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.											
Shuma					1600			1600				
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:						
<table border="1"> <tr> <td data-bbox="177 1816 252 1890">A.1</td> <td data-bbox="252 1816 884 1890">Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.</td> </tr> </table>					A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Transferimi i te ardhurave nga tarifat ,qe mbledhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset e anetare te shoqates te percaktuara sipas listes se aprovuar.											
Shuma					1600			1600				
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Viti 2017, 2018, 2019					g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit							

Nr.25	Projekti: P6.F5.O1.A2 Krijimi i Zonave të reja BID ne Bashkinë Shkodër	Llojet e programit: P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F5. Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.				
a) Peshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Në vazhdim të bashkëpunimit që Bashkia Shkodër ka me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) me projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe Kolë Idromeno, si dhe duke u nisur nga interesimi që bizneset e rrugës Hamz Kazazi (zona Zdrale), kanë shfaqur për të krijuar zonën e tyre BID (Zona e Përmirësimit të Biznesit), Bashkia Shkodër do të mbështesë iniciativën e tyre për të krijuar një zonë të re të Përmirësimit të Biznesit. Qëllimi kryesor i Zonës së Përmirësimit të Biznesit është krijimi i mundësive ekonomike të përmirësuara, siguri dhe një klimë të mirë biznesi mes anëtarëve të saj.						
ii. Synimi i projektit						
Mbështetja e sa më shumë bizneseve të vogël për t'u konsoliduar dhe rritur aktivitetin e tyre ekonomik, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
1. Aprovimi në këshillin e Bashkisë Shkodër të kërkesës për krijim e Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës Hamz Kazazi (Zona Zdrale). 2. Themelimi i Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës Hamz Kazazi (Zona Zdrale). 3. Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të ardhurave nga tarifat, që mblihen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës.						
b) Rezultatet që prisni						
1. Krijimi i Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës Hamz Kazazi (Zona Zdrale). 2. Rritja e cilësisë së shërbimit për vizitorin, të bizneseve që ndodhen përgjatë rrugës Hamz Kazazi.						
c) Aktorët e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër AADF				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.1	Lobim dhe koordinim në mbështetje të procesit për krijimin e zonës BID në rrugën Hamz Kazazi (Zona Zdrale)		Paga	Sigurime	Operative	Transf erime Kapi tale
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2018		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.2	Krijimi i Zonës së Përmirësimit të Biznesit përgjatë rrugës Hamz Kazazi (Zona Zdrale).		Paga	Sigurime	Operative	Transf erime Kapi tale
Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
A.2	Transferimi i të ardhurave nga tarifat, që mblihen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës të percaktuara sipas listës së aprovuar.		Paga	Sigurime	opera tive	Transf erime kapit ale
Shuma		1,000				1,000
f) Periudha e zbatimit Viti 2017, 2018, 2019		g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit				

Nr.26	P6.F5.O1.A3. Nxitja e investimeve në kërkim dhe zhvillimi me qëllim ngritjen e kompanive të reja (Start Up) dhe zhvillimin e SME-ve ekzistuese	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F5 Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Qytet janë qendra të investimeve të cilët janë motorët e rritjes ekonomike. Shkodra ka nevojë për rritjen e numrit të kompanive/sipërmarrjeve Start Up dhe SME-ve, si një mënyrë për rritjen e zhvillimit ekonomik të 11 njësi administrative të Shkodrës. Sipas ligjit kompani të cilat mbështeten në zhvillimin e ngritjen e tyre janë ato kompani që ushtrojnë veprimtarinë e tyre: në sektorët prodhues dhe të shërbimit; në sektorin e industrisë; krijojnë vende të reja pune; në prodhimin për eksport; në sektorin e turizmit; zhvillojnë veprimtaritë në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit; në procesin e agropërpunimit; si dhe në sektorin e artizanatit, sektorë të cilët disa kanë nevojë të konsolidohen e disa të tjerë të krijojnë e zhvillohen në Shkodër.						
ii. Synimi i projektit						
Ky projekt synon promovimin ekonomik, nxitjen e punësimit, krijimin e ndërmarrjeve të reja të vogla dhe të mesme përmes kompanive të reja Start Up dhe zhvillimit të SME-ve ekzistuese.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ofrimi i shërbimeve të informacionit dhe këshillimit; 2. Mbështetja e këtyre ndërmarrjeve dhe nxitjes së bashkëveprimit ndërmjet tyre; 3. Dhënia me qira e pasurive të paluajtshme në pronësi të Bashkisë dhe përmirësimit kushteve të tyre. 						
b) Rezultatet që prisni						
Ngritja e kompanive/sipërmarrjeve të reja Start Up dhe rritja e numrit të SME-ve						
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)			
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë AIDA			Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet per cdo aktivitet 2017				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:	
					Paga	Sigurime
					Operative	Transferime
						Kapitale
f) Periudha e zbatimit				g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:		
2017				Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të		
2018				Klimës së Biznesit		
2019						

Nr.27	P6.F5.O1.A4. Mbështetja dhe lehtësimi i bizneseve për aplikime në programet dhe skema të ndryshme financiare.	Llojet e programit :P6 Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit Funksioni P6.F5 Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.								
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit										
i. Situata										
Bizneset ekzistuese në Shkodër kanë vështirësi për të aplikuar në programe dhe në skemat e ndryshme financiare qeveritare, kjo vjen si rezultat i mungesës së informacionit dhe gjithashtu vështirësive që hasin në plotësimin e dokumentacionit ligjor, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga ministria e linjës apo edhe nga rregulloret e programve të ndryshme. Programet mbështetëse dhe instrumentat financiarë qeveritarë janë një mënyrë e mirë për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe industrisë ushqimore, në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të zonave malore të disavantazuara, rritjen e ekonomisë lokale nga njëra anë dhe nga ana tjetër përforsimi i marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Europian, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e transportit të qëndrueshëm dhe të infrastrukturës publike etj.										
ii. Synimi i projektit										
Shtimi i bizneseve që aplikojnë në mënyrë të suksesshme për të përfituar nga programet dhe skemat e ndryshme financiare shtetërore.										
iii. Aktivitetet kryesore të projektit										
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim; 2. Hartimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar; 3. Ndihmesa për plotësimin e dokumentacionit për aplikim 										
b) Rezultatet që prisni										
Rritja e numrit të bizneseve që përfitojnë nga programet dhe skemat e ndryshme financiare.										
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt						
Bashkia Shkodër Dhoma e Tregtisë AIDA				Bashkia Shkodër						
e) Shpenzimet e llogaritura										
Shpenzimet për cdo aktivitet 2017					Totali (mijë lekë)	Nga kjo:				
A .1 Ofrimi i shërbimeve për dhënie informacioni dhe këshillim;						Paga	Siguri me	Opera tive	Transf erime	Kapi tale
A .2 Hartimi i paketave informuese në lidhje me programet dhe skemat e ndryshme financiare për të cilat mund të jenë të interesuar;										
A .3 Ndihmesa për plotësimin e dokumentacionit për aplikim										
Shuma										
f) Periudha e zbatimit 2017 2018 2019					g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit					

Nr. 29	P6.F6.O1.A1. Krijimi i faqes web për turizmin e rajonit të Shkodrës, hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për ëeb sitin e turizmit.	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F6: Turizëm					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit							
i. Situata							
<p>Një ndër instrumentat më të fuqishëm dhe më aktual të promovimit është promovimi online. Sitet e ndryshme ëeb të destinacioneve turistike janë të natyrave dhe funksioneve të ndryshme. Promocioni online ofron avantazhe të shumta, është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt, është i lirë etj. Aktualisht Bashkia Shkodër ka një ëeb site zyrtar në të cilin jepen edhe informacionet bazë për territorin. Ky ëeb site nuk ofron informacion të mjaftueshëm dhe në shkallën e duhur të zhvillimit aktual të turizmit në Shkodër. Për këtë arsye nevojitet krijimi i një portali të ri ëeb të turizmit në Shkodër. Ky portal do të përmbajë materiale promovionale dhe sidomos informative në të cilin vizitorët do të gjejnë gjithë informacionin që u nevojitet për të vizituar territorin e Shkodrës. Duke qenë se ndryshimet në turizëm janë të konsiderueshme, dhe numri i turistëve po rritet cdo ditë, është i nevojshëm të bëhet azhurnimi i informacioneve të faqes ëeb për turizmin e Bashkisë Shkodër. Dëshirat dhe nevojat e turistëve janë të ndryshme dhe mjaft komplekse, prandaj kjo faqe duhet t'i përshatet sa më shumë atyre duke dhënë informacion sa më të saktë dhe sa më cilësor, duke nxjerrë kështu në pah edhe vlerat e qytetit tonë.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Synohet promovimi i vlerave të veçanta të destinacionit tonë turistik si dhe përmirësimi i informacionit për vizitorët.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Konceptimi dhe strukturimi i materialit që do prezantohet • Zhvillimi i procedurës së prokurimit publik për zgjedhjen e operatorit të specializuar për realizimin e portalit. • Krijimi i një aplikacioni back office në mënyrë që vetë stafi i Bashkisë të mund të përditësojë informacionin. • Publikimi. • Mirëmbajtja. • Përditësimi. 							
b) Rezultatet që prisni							
Ndërtimi dhe mirëmbajtja e Website-it dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër							
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë.(Drejtorja e Turizmit, Drejtorja e të Ardhurave, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj) • Universiteti i Shkodrës • Agjensia Kombëtare e Turizmit 		<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. • Shoqata e Artizanëve • ATA 					
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Module shtesë				190		
A.2	Mirëmbajtje e faqes web				50		
A.3	Hostim				20		
	Shuma	260			260		
f) Periudha e zbatimit 2017 2018 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Turizmit					

Nr. 30	P6.F6.O1.A2. Konceptim dhe krijim i një aplikacioni për smartphone që shërben për informimin dhe orientimin e vizitorëve.	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F6: Turizëm.					
a) Përshkrim i shkurtër i projektit							
i. Situata							
Zhvillimi i turizmit është gjithnjë e më shumë në fokusin e Bashkisë Shkodër dhe githashtu vërehet një interes gjithnjë e në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Një pjesë e mirë e vizitorëve të huaj vijnë në Shkodër në mënyrë të paorganizuar. Përparimet teknologjike i kanë dhënë mundësinë të gjithëve për të pasur akses më të shpejtë e më të lirë në informacionin për destinacione të caktuara. Për të përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët është e nevojshme krijimi i një aplikacioni për smartphone, i cili deri tani mungonte, me informacionet dhe orientimet e nevojshme për kenaqjen e nevojave të vizitorëve. Kjo do ndikonte mjaft në rritjen e mëtejshme të numrit të turistëve në Bashkinë Shkodër. Për të ofruar një cilësi sa më të lartë shërbimi informativ për turistët, nevojitet që aplikacioni për smartphone të mirëmbahet dhe azhurnohet në vazhdimësi. Kjo do ndikonte mjaft në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër.							
ii. Synimi i projektit							
Synohet përmirësimi dhe lehtësimi i aksesit të informacionit për vizitorët.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i procedurës së prokurimit publik për zgjedhjen e operatorit të specializuar për realizimin e portalit • Konceptimi i aplikacionit • Krijimi i aplikacionit • Mirëmbajtja dhe përditësimi i tij. 							
b) Rezultatet që prisni							
Vizitorët do të kenë një instrument informacioni lehtësisht të arritshëm.							
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë.(Drejtorja e Turizmit, Drejtorja e të Ardhurave, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj) • Agjensia Kombëtare e Turizmit 			<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia Shkodër. • Bizneset përfituese të turizmit. • Shoqata e Artizanëve • ATA 				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Total i (mijë lekë)	Nga kjo:				
			Pagaja	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Dizenjimi i aplikacionit për smartphone				60		
A.2	Mirëmbajtje e aplikacionit				20		
A.3	Hostim i aplikacionit në Google Play dhe/ose App Store				40		
	Shuma	120			120		
f) Periudha e zbatimit 2017 2018 2019			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e turizmit				

Nr. 31	P6.F6.O1.A3. Përgatitja dhe publikimi i guidës turistike të Bashkisë Shkodër. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër	Llojet e programit P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni P6:F6: Turizëm					
a) Pershkrimi i shkurter i projektit							
i. Situata							
Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, në vitet e fundit ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Vizitorët e qytetit të Shkodrës janë kryesisht nga Evropa Perëndimore dhe Veriore por vitet e fundit vihet re një prani e shtuar e vizitorëve nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Gjithashtu një numër të madh të vizitorëve e përbëjnë vizitorët etnikë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe kryesisht nga Kosova. Duke parë fluksin e këtyre turistëve dhe mbajtjen e tyre sa më gjatë në destinacionin tonë, duhet të ofrohet një guidë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse. Kjo arrihet nëpërmjet përditësimit, shtimit të itinerareve atraktive për turistët dhe ribotimit të saj, në mënyrë të tillë që të jetë disponibël për turistët.							
ii. Synimi i projektit							
Më anë të këtij projekti synohet të përmirësohet dhe azhurnohet informacioni që u ofrohet vizitorëve .							
iii. Aktivitetet kryesore te projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në guidë. • Përcaktohen termat e referencës apo specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet. • Përditësimi i informacionit dhe shtimi i itinerareve të guidës. • Ribotimi i guidës. • Guidat e prodhuara i vihen në dispozicion Sektorit të Marketingut dhe Shërbimit ndaj Vizitorit për t'iu ofruar vizitorëve. 							
b) Rezultatet që prisni							
Përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së informacionit të ofruar vizitorëve nëpërmjet ribotimit te guidave turistike.							
c) Aktoret e mundshem			d) Kontributet e mundshme ne projekt				
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj • Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. • Bizneset përfituese të turizmit. 			Bashkia Shkodër.				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Ribotimi i guidës		Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapital e
	Shuma	360			360		
f) Periudha e zbatimit 2017 2018 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Turizmit					

Nr. 32	P6.F6.O1.A4. Publikimi i hartës turistike së territorit të Bashkisë. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër.	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F6: Turizëm				
a) Pershkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Ka pasur disa botime hartash turistike për qytetin e Shkodrës të cilat janë vështirësisht të gjindshme dhe tashmë edhe jo aktuale. Me ndryshimet territoriale të territorit administrativ të Bashkisë Shkodër, lind nevoja për botimin e një harte të re dhe në sasi të tillë që të plotësojë nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë. Kjo hartë do të vihet në dispozicion të vizitorëve nga Zyra e Informacionit Turistik të Bashkisë.						
ii. Synimi i projektit						
Synohet përmirësimi cilësor dhe sasior i informacionit për vizitorët.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në hartë. • Përcaktohen termat e referencës apo specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet. • Dizenjimi dhe ilustrimi. • Ribotimi i hartës. • Hartat e prodhuara i vihen në dispozicion Sektorit të Marketingut dhe Shërbimit ndaj Vizitorit për t'iu ofruar vizitorëve. 						
b) Rezultatet që prisni						
Vizitorët do të kenë një material cilësor informativ dhe promociional.						
c) Aktoret e mundshme				d) Kontributet e mundshme në projekt		
<ul style="list-style-type: none"> • Stafi i Bashkisë.(Sektori i Marketingut dhe i Shërbimit ndaj Vizitorit, Sektori i Prokurimeve Publike, etj) • Dega e Turizmit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës. • Bizneset përfituese të turizmit. 				Bashkia Shkodër.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2017		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Ribotim i hartës				310	
	Shuma	310			310	
f) Periudha e zbatimit 2017 2018 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e turizmit				

Nr.33	P6.F6.O1.A5. Publikimi i kalendarit vjetor të aktiviteteve kulturore të Bashkisë.	Llojet e programit: P6: Zhvillimi ekonomik dhe i Turizmit Funksioni: P6:F6: Turizëm				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit						
i. Situata						
Në territorin aktual të Bashkisë Shkodër zhvillohen një seri ngjarjesh dhe aktiviteteve social-kulturore, sportive etj. Pjesa më e madhe e tyre e organizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose e mbështetur në mënyra të ndryshme nga Bashkia. Një pjesë e tyre janë aktivitete me pjesëmarrje të gjërë dhe me potencial të konsiderueshëm për të tërhequr vizitorë edhe nga trevat e tjera të Shqipërisë e më gjërë. Duhet të permiresohet promovimi i informacionit që lidhet me këto festa. Botimi i një kalendarit të eventeve kulturore në territorin e ri tashmë, të Bashkisë Shkodër si dhe ngritja e Zyrës së informacionit turistik do të kontribuonte ndjeshëm në informimin në kohë të vizitorëve potencialë. Gjithashtu informacioni i mbledhur dhe i sistemuar me këtë rast do të publikohet në faqen eeb të Bashkisë Shkodër.						
ii. Synimi i projektit						
Promovimi dhe përmirësimi i informacionit për ngjarjet kulturore në Bashkinë Shkodër.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Fillimisht do të mblidhet informacioni për të gjitha aktivitetet që zhvillohen periodikisht në territorin e Bashkisë Shkodër. • Përcaktohen specifikimet teknike për prokurimin publik që do zhvillohet. • Botimi dhe shpërndarja e kalendarëve. 						
b) Rezultatet që prisni						
